



KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
PRISHTINË - PRISHTINA

**THE EUROPEAN COMMON DEFENSE POLICY AND SECURITY DIMENSIONS.
BETWEEN THE CIVILIAN DEFENSE GOALS AND OBJECTIVES AS WELL AS
MILITARY CAPABILITIES.**

Ardian Elezi, PhD (Cand)

ardael2004@yahoo.com

Abstrakt:

BE përmes instrumenteve të vet të kësaj politike po aktualizon dimensionet e shfaqjes së vet me një profil gjithnjë e më konkurrues përsa i përket menaxhimit të krizave dhe konflikteve rajonale dhe globale. Në këto vite të zhvillimit të kësaj politike është konstatuar që BE në përmbushjen e rolit dhe misionit të vet për një mjedis të paqësor e të sigurtë ka bërë progres në drejtim të qasjes civilo-ushtarake.

Testimi me sukses në shumë misione civile e ushtarake ka rritur ambicien Evropiane për të rritur gjithnjë e më tepër rolin dhe përgjegjësinë që BE duhet të luajë dhe ndërmarrë në ndërtimin e paqes, garantimin e saj, si dhe shuarjen e menaxhimit të krizave dhe konflikteve. Aftësitë civile si dhe ato ushtarake qoftë në aspektin e tyre operacional si dhe karakteristikave të tyre do të jepen në rrafsh evolutiv, që nga origjina e tyre dhe deri në eksperiancat e krijuara anembanë globit si dhe partneritet me organizmat ndërkombëtare.

Instrumentat civilo ushtarak në mbështetje të kësaj politike do të trajtohen të lidhur me objektivat kryesor respektive si ato të Helsinkit, të zhvillimit të aftësive ushtarake, të grupeve të luftimit, karakteristikave të tyre, si dhe sfidave burimore dhe jo vetëm e tyre. Objektivat civile të ndërmarra në këtë kuadër do të prezantohen të lidhura me rritjen e aftësive e kapaciteteve të BE në përballimin e menaxhimit të krizave civile, si komponenti më konkurrues dhe më thelbësor i politikës së jashtme të BE-së.

Këto dimensionet do të shihen të ndërthurura brënda një kuadri konceptual të menaxhimit strategjik, ku përballë sfidave të mjedisit ndërkombëtar të sigurisë, BE ka çfarë ofron me mundësitë e vet operationale.

Fjale kyçe: *Objektivat e Helsinikut, aftësi civile e ushtarake, grupe luftimi, marrëveshja Berlin Plus, Politika e Përbashkët e Sigurisë dhe Mbrojtjes Evropiane etj.*

